



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**BASHKIA DURRËS**  
**QENDRA EKONOMIKE E ARSIMIT**

Durrës, më 14.02.2025

**PROCESVERBAL**  
**Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE  
PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROCEDURËS:** :“Blerje materiale pastrimi për institucionet e QEA-s Durrës”

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP):** Emërtimi dhe identifikimi i Kodi CPV: **Detergjent** - 39831200-8.

**VLERA E FONDIT LIMIT:** 10,000,000 (dhjetë milion) Lek pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Qendra Ekonomike e Arsimit (QEA)** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**- PËRLLOGARITJA E VLERËS LIMIT TË KONTRATËS**

Në zbatim të urdhrit të grupit të punës për përllogaritjen e fondit limit dhe specifikimeve teknike nr 14 prot 2 datë 19.01.2024 “për ngritjen e grupit të punës për hartimin e specifikimeve teknike si dhe përllogaritjen e fondit limit për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje materiale pastrimi për institucionet e QEA-s Durrës”., si dhe

Për përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, mbështetur në LigjinNr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si edhe VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe në Vendimit të Këshillit të Bashkiak nr.195 , datë 22.12.2023, “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2024, si dhe projektbuxhetin afatmesëm të Bashkisë Durrës për vitet 2024-2026”,

Në përlogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t'i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë: çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj); ose/dhe

a) çmimet e tregut; ose/dhe

b) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe

ç) çmimet ndërkombëtare, të botuara.

Në vijim të Urdhërit nr 14 prot 2 datë 19.01.2024 “për ngritjen e grupit të punës për hartimin e specifikimeve teknike si dhe përlogaritjen e fondit limit për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje materiale pastrimi për institucionet e QAE-s Durrës”, grupi i punës, pasi u njoh me objektin e prokurimit, e rifilloi punën për hartimin e dokumentacionit duke pasqyruar në të dhe ndryshimet përkatëse.

Grupi i punës realizojë punë kërkimore mbi çmimet orientuese për mallrat, të cilat janë objekt prokurimi; duke u bazuar në Çmimet e Instatit, hetimin e tregut vendas si dhe kontratat e mëparshme, nisur nga kriteret e përcaktuara nga komisioni, u testua tregu dhe çmimet e kontratave të mëparshme. Në fund të procesit u siguruan çmimet e vlerësuar për artikujt e ndryshëm të materialeve të pastrimit dhe dizinfektimit. Pas përlogaritjes së preventivit të hartuar nga grupi i punës, pas studimit të tregut, vlera e përgjithshme rezulton të jetë **10,000,000** lekë pa Tvsh.

Në përfundim, pas hartimit të preventivit, për objektin e prokurimit me titull: “Blerje materiale pastrimi për institucionet e QEA-s Durrës”

Komisioni bazuar në vlerën e preventivit vendosi që:

Vlera e fondit limit rezulton: **10,000,000** (dhjetë milion ë) **lekë pa TVSH.**

- **Afati kohor:**

Për realizimin e punës dhe zbatimin e kontratës duhet të jetë 12 muaj, ku furnizimi do të kryhet 1 (një) herë në muaj, në magazinën e Qendrës Ekonomike të Arsimit.

- **Garancia** për mbulimin e difekteve, që mund të lindin gjatë realizimit të objektit të prokurimit, nga ana e operatorit ekonomik të jetë 12 muaj.

## **1. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:**

a. Sigurim oferte, sipas *Shtojcës 4*;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas *Shtojcës 9*;

2

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP-së, i ndryshuar, nenit 26, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

## **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë: Sipas pikës 2.3**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP-së i ndryshuar, nenin 40, pika 5, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

### **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022, 2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 10.000.000 lek.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP-së, i ndryshuar, si dhe nenet 43 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

*Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:*

*Vlera e kërkuar është në përpjestim të drejtë me fondin limit të procedurës.*

*Kërkesat e mësipërme i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjëndjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.*

*Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e xhiros është vendosur që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjëndjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.*

*Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në mbështetje të Ligjit 9920, datë 19.05.2008 ”Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 64 Deklarata Tatimore; Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 ”Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, ”Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.*

*AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.*

**2.2.2** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2021, 2022, 2023) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP-së i ndryshuar, të neneve 43, pika 4 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, si dhe bazuar në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”

**2.2.3** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin një dokument që vërteton se (subjekti juaj) i ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, për vitin 2024 referuar ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, si dhe sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak përkatës ku subjekti ushtron aktivitetin, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë këtë dokument).

*Ky kriter përmbushet nëpërmjet paraqitjes së Formularit përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 në DST.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, e LPP-së i ndryshuar, si dhe të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

*Kjo kërkesë bazohet në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore. Shlyerja e detyrimeve vendore për vitin 2024 ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.*

*Dokumentet e kërkuara me sipër, do të paraqiten nga operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.*

## **2.3 Kapaciteti teknik dhe profesional:**

**2.3.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se

4.000.000 lek. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 40, pika 4, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

*Referuar fondit limit sipas nenin 40 pika 4, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.*

---

*Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg.*

**2.3.2** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë punonjës të specializuar/ të kualifikuar, si më poshtë:

- a. Drejtues mjeti 1 (një)
- b. Punëtorë të thjeshtë 2 (dy)

Drejtuesi i mjetit të jetë i pajisur me leje drejtimi brenda afatit të vlefshmërisë. Ndërsa për punëtorët e thjeshtë të disponojë një vetëdeklarim nga Shoqëria ku listohen si punëtorë të thjeshtë.

**Argumentimi:** *Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit dhe/ose komponentët e tij. Për shpërndarjen e mallrave nevojiten 2 (dy) punëtorë të thjeshtë për ngarkim shkarkimin e mallrave dhe shoferi i mjetit të transportit.*

*Ky kriter përmbushet nëpërmjet paraqitjes së Formularit përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 në DST.*

**2.3.3** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë një staf punonjësish prej **minimalisht 3 persona ( Të jenë në listëpagesën e shoqërisë sipas formularëve standart për sigurimet, për muajin e fundit).**

**Argumentim:** *Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.*

*Numri i kërkuar i punonjësve është përlllogaritur si më poshtë:*

*Bazuar në volumin e punës, dhe preventivin e hartuar duke qenë se mallrat që do të blihen, të cilët janë objekt prokurimi, do të shërbejnë për Qendrën Ekonomike të Arsimit Bashkia Durrës, për nga do të bëhet shpërndarja e tyre në magazinën qendrore 1 herë në muaj për periudhën totale 12 muaj, prandaj nevojitet një mjet, i cili duhet të jetë i pajisur me 1 (një) shofer/drejtues mjeti dhe 2 (dy) punëtorë për shkarkimin e mallit.*

*Ky kriter përmbushet nëpërmjet paraqitjes së Formularit përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 në DST.*

**2.3.4** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Operatori ekonomik duhet të disponojë 1 (një) mjet për transport mallrash , në pronësi të tij ose të marra me qera , që do të shërbejë për kryerjen e shërbimit të transportit të materialeve të pastrimit për objektin e prokurimit.

Kjo të vërtetohet me dokumentacionet: Leje Qarkullimi, Polica e sigurimit të Detyrueshëm të Mbajtësve të Mjeteve Motorrike për Përgjegjësinë ndaj Palëve të Treta, Certifikata e Kontrollit Teknik, Certifikatë Transporti Mallrash lëshuar nga organi kompetent në rast se mjeti ka kapacitet mbartës (transportues)  $\geq 1.5$  ton, foto të mjetit.

**Argumentim:** *Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.*

*Ky kriter përmbushet nëpërmjet paraqitjes së Formularit përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 në DST.*

## **2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim:**

### **2.4.1 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë certifikatat:**

a. Çertifikatë për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë ISO 9001, i cili duhet të përkojë me kategorinë dhe specifikën e produkteve dhe të shërbimeve që prokurohen. *Certifikatat të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë;*

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në neni 40, pika 3, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe pika 1 ,2 të nenit 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” . Autoriteti Kontraktor ka kërkuar pajisjen e operatorit ekonomik me këtë certifikatë, për të vërtetuar se mallrat, si objekt prokurimi, plotësojnë kërkesat e cilësisë dhe shpreh garancinë për to. Kjo kërkesë dëshmon se mbajtësi i saj garanton standartet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të veprimtarisë së tij.*

b. Certifikatë për Sistemin e Menaxhimit të Mjedisit ISO 14001, i cili duhet të përkojë me kategorinë dhe specifikën e produkteve dhe të shërbimeve që prokurohen. *Certifikatat të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë;*

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në neni 40, pika 3, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe pika 1 ,2 të nenit 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” . Autoriteti Kontraktor ka kërkuar pajisjen e operatorit ekonomik me këtë certifikatë, pasi në objektin e prokurimit janë disa mallra cilësia jashtë standartit e të cilave do të ndikonte keq në mjedis. Sistemi i Menaxhimit Mjedisor ISO 14001 ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që produktet kanë mbi mjedisin.*

c. Certifikatë për specifikimet për sistemin e menaxhimit të sigurisë për zinxhirin e furnizimit ISO 28001 – 2007. *Certifikatat të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”;*

Në rast se operatori ekonomik nuk është prodhues i artikujve të kërkuar, duhet të paraqesë Autorizim nga Prodhuesi ose Kontratë Furnizimi/Bashkëpunimi me një Distributor të Autorizuar për furnizimin e mallrave për objektin e prokurimit. (Në rastin e distributorit të autorizuar duhet të paraqitet dokumenti që vërteton lidhjen midis Prodhuesit dhe Distributorit). Autorizimi apo Kontrata, duhet të përmbajjë të dhënat e plota të prodhuesit apo kontraktuesit (Distributor i Autorizuar) si: telefon, fax, e-mail, ëbsite.

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në neni 40, pika 3, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe pika 1 ,2 të nenit 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” . Autoriteti Kontraktor ka kërkuar pajisjen e operatorit ekonomik me këtë certifikatë, për të vërtetuar se mallrat, si objekt prokurimi, plotësojnë kërkesat e cilësisë dhe shpreh garancinë për to.*

*Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.*

**2.4.2** Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë, fletë –analizë për mallrat e mëposhtme:

Nr	Emertimi	Njësia	Sasia
1	Detergjent larës pllakash dhe pajisjesh	copë	1
2	Sapun Tualeti	copë	1
3	Solucion larës enësh xhel	copë	1
4	Sapun i lëngshëm me aplikator	copë	1
5	Solucion për larje xhamash	copë	1
6	Acid Muriatik për pastrim	copë	1
7	Solucion zbardhues higjenizues	copë	1

(Fletët e analizës, të cilat do ti bashkangjiten dokumentave elektronikisht, të jenë të lëshuara nga institucione të autorizuar/certifikuara, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike).



**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në neni 40, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, kërkohen për të garantuar furnizimin me produkte të kontrolluara dhe certifikuara nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial dhe/ ose çdo institucion i autorizuar, pasi këto produkte janë të një përditshmërie dhe cilësia jashtë standartit mund të ndikojë negativisht në shëndetin e përdoruesve.*

## **2.5 Kriter për shpalljen e ofertës fituese**

Bazuar në pikën 3, neni 45, Seksioni III “Kërkesa të veçanta sipas tipeve të kontratave”, VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar: Për punët/mallrat/shërbimet që kanë specifikime të thjeshta, standarde teknike të mirënjohura dhe janë lehtësisht të gjendura në treg, oferta ekonomikisht më e favorshme, bazohet në **çmimin si i vetmi element i ndryshueshëm ndërmjet ofertave...**”

Ofertuesi i kualifikuar i pari, duhet të dorëzojë pranë autoritetit kontraktor dokumentacionin e parashikuar në pikën 6 të nenit 26 të VKM- së nr.285, datë 19.05.2021 i ndryshuar, brenda afatit 7 ditor që ka në dispozicion autoriteti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, sipas nenit 97/1 të LPP-së, i ndryshuar.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për s`kualifikim.

## **II Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe neni 36, të LPP, si dhe neni 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë, për blerjet e reja, cilësore, garantimin e cilësisë së kërkuar, karakteristikat e duhura bashkëkohore, standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe neni 36 të

Ligjit nr 162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimi Publik”, si edhe nenit 40, pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”:

Bazuar në specifikimet teknike të hartuara nga struktura e posaçme e ngritur me urdhër të titullarit të autoritetit kontraktor konstatohet se plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 36 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin publik” i ndryshuar, dhe nenin 40 pika 2 të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021“Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, në këto kushte njësia e prokurimit po publikon specifikimet teknike.

Specifikimet teknike dhe fondi limit i kontratës janë hartuar prej Autoritetit Kontraktor për nevojat e së cilës po kryhet kjo procedurë prokurimi.

Sipas specifikimeve bashkëngjitur të hartuar, vendosur dhe përlogaritur nga struktura të posaçme të specializuara, e konkretisht nga: “Grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përlogaritjen e fondit limit”, mbështetur në Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Specifikime teknike, preventivi, afati dhe kriteret kualifikuese u pasqyruan në DT

Dokumentet e tenderit me kërkesat si më sipër firmosen nga anëtarët e njësisë së prokurimit, pas miratimit të gjithë anëtarët e njësisë kanë akses (autorizohen) për botimin e tyre në rrugë elektronike pranë APP([www.app.gov.al](http://www.app.gov.al)).

### **Njësia e Prokurimit**